



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Org. jed./Mj. org./Org. unit: o.p.
Br. s./Nr. f./No. p.: 02-073/ Br. Nr./No.: 2026
Datum/Data/Date: 30. 04. 2026
OPŠTINA RANILUG - KOMUNA E RANILLUGUT

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Në bazë të nenit 12, paragrafit 12.2, pika (d), nenit 17, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e RKS nr. 28/2008), nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 6, paragrafi 1.2, pikat 1.2.1 dhe 1.2.2, si dhe nenet 10, 11 dhe 15 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e RKS nr. 20/21), Udhëzimit Administrativ (MMPH) për elementet bazë dhe kërkesat për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale nr.11/2015, Udhëzimit Administrativ (MMPH) për normat teknike të planifikimit hapësinor nr. 08/2017, nenit 8 paragrafi 8.1 pika (b) dhe nenit 15 paragrafi 15.1 të Statutit të Komunës së Ranillugut nr.02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut, në mbledhjen e katërt të rregullt të mbajtur më 30.04.2026, miratoi:

VENDIM PËR
VAZHDIMIN E VLEFSHMËRISË SË PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË
RANILLUGUT 2012–2022 + DERI MË 31.12.2026

1.

Propozim-vendimi i paraqitur ka kaluar shqyrtimin kryesor në mbledhjen e katërt të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut, të mbajtur më 30.04.2026, ku është aprovuar dhe miratuar me shumicë votash.

2.

Miratohet vendimi për zgjatjen e vlefshmërisë së Planit Zhvillimor të Komunës së Ranillugut 2012–2022 + deri më 31.12.2026.

3.

Komuna e Ranillugut ka filluar procedurën për hartimin e Planit të ri Zhvillimor dhe, për shkak të nevojës për funksionim dhe vazhdimësi të zhvillimit të komunës, është e domosdoshme zgjatja e vlefshmërisë së Planit të vjetër Zhvillimor.

4.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Zhvillimor i Komunës së Ranillugut 2012–2022 +.

5.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetares dhe të gjitha drejtoritë komunale të Komunës së Ranillugut.

6.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Data: 30.04.2026

Ranilug



Kryesuesi i KK së Ranillugut

Ivan Krstiq
Ivan Krstiq